



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 1439/5 Prot.

Tiranë më 5.11.2019

VENDIM

Nr. 31, datë 5.11.2019

PËR KONTROLLUESIN "DONALD RAMA – PRO SHOP"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112, të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Donald Rama – Pro Shop",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.281, datë 11.10.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 14.10.2019 u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Donald Rama – Pro Shop" me objekt:

- Zbatimit të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale si dhe verifikimi i ankesës në lidhje me marketingun e drejtpërdrejtë nëpërmjet telefonisë (numrit +35545620238) drejtuar numrit +3556820XXX14, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi "Donald Rama – Pro Shop".

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "Donald Rama – Pro Shop", konstaton se:

1. Subjekti "Donald Rama – Pro Shop", ushtron aktivitetin tregtar në fushën e shitjeve direkte të produkteve të ndryshme duke filluar nga data 24.12.2015, sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit.
2. Gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar, subjekti tregtar "Donald Rama – Pro Shop", mbledh të dhënat e klientëve të cilat konsistojnë në "numër telefoni celular". Në

kuptim të nenit 3, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar, subjekti *"Donald Rama – Pro Shop"* është kontrollues i të dhënave personale, në rastin konkret, për numrat e telefonit celular dhe emrat e qytetarëve të kontaktuar për qëllime marketingu.

3. Me objekt ofrimin e produkteve, numri +35545620238 ka kryer thirrje telefonike drejt numrit celular 068*****14. Nga të dhënat e marra nga kompania që ofron shërbimin e telefonisë, rezulton se ky numër është në pronësi të *"Donald Rama – Pro Shop"* me NUIS: L52424013A.

Kontrolluesi nuk ka administruar pëlqimin e subjekteve për t'u telefonuar në numrat personal mbi ofertat e produkteve për qëllime marketingu në kundërshtim me parashikimin e gërmës "a", të pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr.9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.6, datë 28.05.2010 *"Mbi përdorimin korrekt të sms-ve për qëllime promovionale, reklama, informacione, shitjeve direkte, nëpërmjet telefonisë celulare"*, të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se pëlqimi i subjekteve të të dhënave është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale, për arsye se nuk konstatohen kritere të tjera të ligjshme përpunimi nga ana e kontrolluesit. Në çdo rast, pëlqimi duhet të jepet me vullnetin e lirë dhe duhet të jetë i provueshëm (në formë shkresore dhe sipas rastit, edhe në formë elektronike), në zbatim të pikës 24, të nenit 3, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar.

Për sa kohë kontrolluesi nuk ka mundur të provojë ekzistencën e pëlqimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave është i paligjshëm, duke cënuar edhe parimin e sanksionuar në gërmën "a", të pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar.

Mos kryerja e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë, sipas gërmës "a", të pikës 1, të nenit 39, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar.

4. Kontrolluesi ka *"Njoftuar"* Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21, dhe 22, të ligjit nr. 9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar.

Njoftimi mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat kontrolluesi është përgjegjës, është një detyrim ligjor i rëndësishëm pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi kategorinë e të dhënave që përpunohen, qëllimin e përpunimit të tyre, realizimin e detyrimeve ligjore nga ana e kontrolluesit etj.

4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit;
5. Kontrolluesi “*Donald Rama – Pro Shop*”, të pezullojë menjëherë përpunimin e të dhënave personale që zhvillon përmes marketingut të drejtpërdrejtë dhe të realizojë seleksionimin dhe klasifikimin e tyre si:
 - Të dhëna personale të siguruar në rrugë të drejtë e ligjore,
 - Të dhëna personale të siguruar në mënyrë jo të drejtë dhe të paligjshme.
6. Kontrolluesi “*Donald Rama – Pro Shop*” pasi të ketë vepruar sipas pikës 5 të këtij vendimi, duhet të realizojë shkatërrimin e të gjitha të dhënave personale të siguruar në mënyrë jo të drejtë dhe të paligjshme;
7. Në zbatim të nenit 32/1, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 5, dhe 6, të këtij Vendimi, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijani. Pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi masat e marra në zbatim të detyrimeve të lëna.

Vendimi i sipërcituar nr.36, datë 23.06.2016 i Komisionerit, është si rezultat i ankesës nga mbajtësi i po të njëjtit numër, për të cilin ka dalë edhe urdhri nr.281, datë 11.10.2019 i Zyrës së Komisionerit. **Ndërkohë, nga inspektimi i kryer më datë 14.10.2019, rezultoi se Kontrolluesi “Donald Rama - Pro Shop” nuk ka reaguar për përmbushjen e detyrimeve të lëna në Vendimin nr.36, datë 23.06.2016, duke u cilësuar si përsëritës në shkeljet administrative.**

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin, i cili është nënshkruar nga ana e Z. Donald Rama me pretendimin se: “*Mora dijani për konstatimet e procesverbalit. Do marr masa për përmbushjen e konstatimeve të cilat do ju dërgohen në adresën zyrtare*”.

Në zbatim të neneve 87-89, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, kontrolluesi “*Donald Rama – Pro Shop*” është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore në datën 31.10.2019, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi nuk është paraqitur në seancën e caktuar, ndonëse ka marrë dijani si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion me shkrim pranë Zyrës së Komisionerit. Për rrjedhojë, Komisioneri ka vijuar, me marrjen e vendimit përfundimtar sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 88, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”: “*Organi publik merr vendimin përfundimtar vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar për ushtrimin e së drejtës për t’u dëgjuar nga pala. Mos ushtrimi i kësaj së drejte nga ana e palës në afatin e përcaktuar, nuk shkakton shtyrjen e marrjes së vendimit përfundimtar*”.

5. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregulla specifike për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e sigurisë e të dhënave personale, sipas detyrimit të nenit 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi i një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale si një akt bazë i cili ndërjegjëson dhe detyron punonjësit për ruajtjen e konfidencialitetit, ruajtjen nga keqpërdorimi dhe mënyrën e administrimit të të dhënave personale.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 150.000 lekë, sipas parashikimit të gërmës "dh", të pikës 1, të nenit 39, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

6. Në kuadër të zbatimit të detyrimit për informim, Kontrolluesi "*Donald Rama – Pro Shop*", gjatë mbledhjes së të dhënave personale nuk informon subjektet e të dhënave mbi qëllimin dhe përpunimin e të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e ruajtjes së tyre si dhe masat e sigurisë në zbatim të detyrimit të parashikuar në nenin 18, të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

Në frymën e ligjit, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht mënyrës së mbledhjes së të dhënave, faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, ka detyrim që të informojë çdo subjekt të dhënash mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e ruajtjes së tyre si dhe masat e sigurisë në zbatim të detyrimit të parashikuar në nenin 18, të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 300.000 lekë, sipas gërmës "b", të pikës 1, të nenit 39, të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

Ndaj këtij kontrolluesi është kryer hetim administrativ i mëparshëm dhe Zyra e Komisionerit me Vendimin nr.36, datë 23.06.2016 të Komisionerit, ndaj Kontrolluesit "*Donald Rama – Pro Shop*", ka vendosur:

1. Dënimi i kontrolluesit "*Donald Rama – Pro Shop*", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 6/1/a, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.
2. Dënimi i kontrolluesit "*Donald Rama – Pro Shop*", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.
3. Kontrolluesi "*Donald Rama – Pro Shop*", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar;

Mos përmbushja e këtyre detyrimeve, në kuptim të gërmës "a", "b", dhe "dh", të pikës 1, të nenit 39, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë:

- a) "Kontrolluesit që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me Kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10.000 deri në 500.000 lekë";
- b) Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- dh) "Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10.000 deri në 150.000 lekë".

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, Kontrolluesi nuk ka reaguar për përmbushjen e këtyre detyrimeve si dhe është përsëritës në shkeljet e konstatuara, të cilat lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 18, 27, 29, 30, 39, pika 1, gërmat "a", "b" dhe "dh", si dhe nenet 40, dhe 41, të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Donald Rama – Pro Shop", me gjobë në vlerën 240.000 (dyqindedyzet mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 6, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "Donald Rama – Pro Shop", me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 18, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3. Dënimin e kontrolluesit "Donald Rama – Pro Shop", me gjobë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
4. Kontrolluesi "Donald Rama – Pro Shop", të marrë masa të menjëhershme për shkatërrimin e të dhënave të klientëve të përpunuara në kundërshtim me nenin 6, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim

kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.

6. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 5.11.2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

